



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Nr. 1311 prot., datë 8.03 2013



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. 3934 prot., datë 19.10.2013

UDHËZIM

Nr. 7 datë 8.03 2013

PËR

NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 29/1, DATË 16.08.2011 "PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE QË KRYEN AGJENCIA PUBLIKE E AKREDITIMIT TË ARSIMIT TË LARTË"

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 60, nenit 61 dhe nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe të nenit 14 të Vendimit nr. 424, datë 02. 06. 2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimit dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë" i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Në tabelën e pikës 1 të udhëzimit nr. 29/1 datë 16.08.2011 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë", pikat a) dhe ç) revokohen.
2. Në pikën 1 të shkronjës a) të tabelës në pikën 2 të udhëzimit, hiqet shprehja "ose kolegji", dhe në tabelë shtohet një pikë 3, me përmbajtje si më poshtë:

3. Një kolegji profesional	376.000
----------------------------	---------

3. Shkronja ç) e tabelës në pikën 2 të udhëzimit ndryshohet si më poshtë:

ç) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i shkollës doktrale dhe i një programi studimi të ciklit të tretë:		
1. Tarifa për akreditim ose vlerësim paraprak (shkenca sociale e humane)		552.000
2. Tarifa për akreditim ose vlerësim me ekspertë të huaj (fusha mjekësore dhe shkenca natyrore)		602.000
3. Tarifa për akreditim ose vlerësim të Shkollës Doktorale (Njësi Bazë) duke përfshirë të gjitha programet e ciklit të tretë që ofron kjo Shkollë Doktorale	Ekspertë vendas dhe të huaj	1.180.400

4. Pas shkronjës ç), shtohet një pikë d), me përmbajtje si më poshtë:

d) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i një programi profesional me kohëzgjatje 2 (dy) vjet:	
Tarifa për vlerësimin ose akreditimin e një programi të ciklit të shkurtër 2-vjeçar profesional	45.000


5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Myqerem Tafaj

MYQEREM TAFAJ



MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

RIDVAN BODE

